



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “THOMA PAPAPANO” GJIROKASTËR

Nr. 82 Prot.

Gjirokastër, më: 16/03/2023

Lënda : Njoftim për lëvizje paralele

Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr. 15 datë 16/02/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019, “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funkcionit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, “Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore , Përbërjes së Njësisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional “,

Shkolla e Mesme Profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastër ,ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- Mësimdhënës ,me kohë të pjesëshme , të teorisë profesionale , drejtimi Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.

1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) te kete diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlefshme, në të njëjten fushë me kualifikimin profesionale te kërkuar

b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2.Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- Letërmotivimin për pozicionin;

- Jetëshkrimin (Cv-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit 14 dt. 27.05.2021).

- Kartën e identitetit;

- Diplomën;

-Librezën e punës;

-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet , trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

- Çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

-Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;

-Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;

-Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

-Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

-Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

-Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e shkollës brenda datës 28.3.2023 .

Drejtori

Renata Puleri

